



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 17 MAJ 2018, TIRANË

PROCESVERBAL

**SEANCËN E DREJTON
KRYETARI I KUVENDIT
GRAMOZ RUÇI**

(Seanca filloi në orën 10:00)

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit të seancës plenare të datës 10.05.2018 (neni 44 i Rregullores)

2. Njoftimi i projektligjeve të depozituara në Kuvend (neni 44, pika 3, i Rregullores)

3. Betimi i deputetit të ri (nenet 4, 13, pika 5, të Rregullores)

4. Raporti vjetor i veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Diskutime (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

5. Raporti vjetor i veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017 (neni 103 i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Shprehet titullari i institucionit *(jo më shumë se 60 minuta)*.

Shprehet Komisioni përgjegjës për Ekonominë dhe Financat.

Pyetje

Diskutime (nëse kërkohet me shkrim nga një komision i përhershëm, një kryetar grupi ose 10 deputetë)

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit

6. Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”” (nenet 73-77 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare.)

Koha e votimit (në parim/nen për nen/në tërësi)

7. Projektligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë” (neni 27, pikat 3 dhe 4 të Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

Pyetje

Shprehet Komisioni përgjegjës për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik.

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Integrimin European

Shprehet për dhënie mendimi Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Diskutime

(Shprehen grupet parlamentare)

Koha e votimit (në parim/nen për nen/në tërësi)

8. Miratimi i programit të punës së Kuvendit për periudhën 21 maj – 29 qershor 2018 (neni 26, pikat 5, 6, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

9. Miratimi i kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën 21 maj – 8 qershor 2018 (neni 27, pikat 3, 4, i Rregullores, votim me shumicë të thjeshtë)

10. Diskutime për çështje jashtë rendit të ditës (neni 45 i Rregullores)

Koha e diskutimeve deri në 60 minuta

Gramoz Ruçi – Të futet media brenda!

Seancën e ditës së sotme e deklaroj të hapur.

(Pasi lexon rendin e ditës.)

Ju njoftoj se vijon puna në komisionet parlamentare për shqyrtim e çështjeve të parashikuara për ditën e sotme.

A ka vërejtje për procesverbalin? Nuk ka.

Miratohet.

Ju njoftoj se nga Këshilli i Ministrave janë depozituar tri projektligje. Materialet do t’i gjeni në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Për betimin e deputetit të ri, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve është depozituar në Kuvend vendimi për dhënien e mandatit të deputetit kandidatit në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të qarkut të Tiranës. Lidhur me këtë çështje, ju njoftoj se ditën e hënë Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin u mbledh për të verifikuar mandatin e deputetit të ri Spartak Braho, PS. Opozita nuk mori pjesë në mbledhje. Për deputetin nuk rezultoi asnjë paligjshmëri në zgjedhje, që ta pengojë atë të bëjë betimin në seancë plenare. Raportin e anëtarëve të Këshillit, që morën pjesë në mbledhje, e keni të gjithë përpara. A jeni dakord me raportin?

Miratohet.

Para se të vazhdojmë me çështjet e tjera, në mbështetje të nenit 72 të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 1, të Rregullores së Kuvendit, ftoj deputetin e ri të bëjë betimin, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit. Në mbështetje të nenit 4, pika 3 të Rregullores, unë do të lexoj tekstin e betimit dhe ftoj zotin Braho të ngrihet në këmbë dhe të deklarojë “Betohem”.

Teksti i betimit është: “Betohem me nderin tim se do të kryej me ndërgjegje

detyrën si deputet i popullit në Kuvend. Do të përfaqësoj denjësisht popullin, do t’u bindem Kushtetutës dhe ligjeve, do të mbroj lirinë dhe pavarësinë e Shqipërisë, do të respektoj dhe do të mbroj të drejtat dhe liritë e shtetasve dhe do të punoj me të gjitha fuqitë e mia për përparimin e Atdheut dhe mirëqenien e popullit tim.”

Spartak Braho – Betohem.

Gramoz Ruçi – Urime, zoti Braho!

Fillojmë me raportin vjetor të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2017. Ftoj Guvernatorin e Bankës së Shqipërisë, zotin Gent Sejko, të na paraqesë raportin.

Gent Sejko – Mirëmëngjesi!

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Banka e Shqipërisë e sheh procesin e llogaridhënies si një element esencial të aktivitetit të saj. Ky proces plotëson pavarësinë tonë institucionale, rrit transparencën dhe besueshmërinë e Bankës së Shqipërisë, si dhe përmirëson efektivitetin e politikave tona. Për këtë arsye është kënaqësi për mua të prezantoj përpara jush punën dhe rezultatet e Bankës së Shqipërisë për vitin 2017.

Dëshiroj ta filloj këtë raportim duke ndarë me ju tri mesazhe të rëndësishme, të cilat pasqyrojnë konkluzionet e analizave tona dhe kanë qenë lajtmotivi i komunikimit tonë publik gjatë vitit të shkuar.

Së pari, ekonomia dhe sistemi financiar shqiptar kanë shënuar progres gjatë vitit 2017. Trendi pozitiv i zhvillimit ilustruhet nga përsheptimi i ritmit të rritjes ekonomike, nga rritja e punësimit, nga rënia e normës së papunësisë, si dhe nga përmirësimi i bilanceve financiare të sektorit publik dhe privat shqiptar. Ky progres e ka sjellë ekonominë shqiptare afër nivelit të saj potencial dhe ka forcuar faktorët afatshkurtër dhe afatmesëm, të cilët mbështesin rritjen ekonomike.

Së dyti, gjatë vitit të shkuar, aktiviteti i Bankës së Shqipërisë ka qenë në përputhje me detyrat tona ligjore dhe në linjë me rekomandimet e Kuvendit të Shqipërisë.

Politika dhe instrumentet tona kanë pasur një ndikim pozitiv në të gjithë fushën e veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë; në nxitjen e rritjes ekonomike nëpërmjet ndjekjes së një politike monetare stimuluese; në forcimin e stabilitetit financiar nëpërmjet zbatimit të një politike mbikëqyrëse, rregullatore, të kujdesshme dhe proaktive; në nxitjen e zhvillimit dhe rritjen e eficiencës së sistemit financiar nëpërmjet mirëmbajtjes dhe zhvillimit të sistemit të pagesave, nëpërmjet vëmendjes së vazhdueshme që ushtrojmë ndaj edukimit financiar, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit dhe iniciativave të përbashkëta me agjenci dhe partnerë të brendshëm dhe të huaj.

Së treti, dua të tërheq vëmendjen në faktin se, pavarësisht premisave pozitive të zhvillimit, ekonomia shqiptare vazhdon të përballlet me disa sfida afatmesme dhe afatgjata zhvillimi.

Identifikimi dhe reduktimi i vulnerabiliteteve ekonomike e financiare, shmangia e rreziqeve potenciale, si dhe vazhdimi i reformave strukturore, në interes të përsheptimit të ritmit të rritjes së vendit, janë disa nga sfidat kryesore me të cilat përballemi. Detyra jonë si politikëbërës është hartimi dhe zbatimi i planeve konsistente dhe konsekuente të veprimt, për të adresuar në kohë të gjitha problemet me të cilat përballemi.

Më lejoni të ndalem më gjatë në secilën nga çështjet e mësipërme, duke filluar me një pasqyrë të zhvillimeve kryesore ekonomike dhe financiare të vitit të shkuar.

Ekonomia dhe sistemi financiar shqiptar gjatë vitit 2017

Viti që lamë pas ka qenë një vit progresi për ekonominë dhe për sistemin financiar shqiptar. Sipas të dhënave të INSTAT-it, vëllimi i aktivitetit ekonomik u rrit me 3,8% gjatë vitit 2017, duke regjistruar një dinamikë pozitive në krahasim me normat prej 2,2% dhe 3,4% të rritjes së shënuar gjatë viteve 2015 dhe 2016. Zgjerimi i aktivitetit ekonomik rezultoi me bazë të gjerë. Nga këndvështrimi i kërkesës agregate ai u mbështet nga rritja e konsumit, investimeve dhe eksportit. Rritja ekonomike e vendit ka përfutuar nga përmirësimi i ambientit të huaj, si dhe është mbështetur nga kushtet e favorshme të financimit në vend dhe nga besimi i agjentëve ekonomikë. Nga këndvështrimi sektorial, zgjerimi i kërkesës agregate ndihmoi në rritjen e aktivitetit, kryesisht në sektorin e shërbimeve dhe në degë të caktuara të sektorit të industrisë.

Një zhvillim i spikatur për vitin 2017 ishte ecuria pozitive e sektorit të turizmit, i cili siguroi një impuls pozitiv në rritjen ekonomike. Rritja ekonomike mundësoi krijimin e rreth 79 mijë vendeve të reja pune në sektorin privat jobujqësor. Gjatë vitit 2017 punësimi total u rrit me 3,3%, i ndikuar në masë të madhe nga rritja e punësimit në sektorin e shërbimeve. Paralelisht me rritjen e punësimit, shkalla e papunësisë u ul nga 14,2% në fund të vitit 2016, në 13,4% në fund të vitit 2017.

Gjatë vitit 2017 inflacioni erdhi në rritje, duke shënuar një nivel mesatar prej 2%, krahasuar me 1,3%, që ishte një vit më parë. Rritja e inflacionit pasqyroi përmirësimin e aktivitetit ekonomik dhe forcimin e presioneve të brendshme inflacioniste. Megjithatë, ky tregues vijon të mbetet nën objektiv, në refleksim të

pranisë së kapaciteteve të pashfrytëzuara në ekonomi, të nivelit të ulët të inflacionit në vendet partnere, si dhe të fortësisë së kursit të këmbimit.

Zgjerimi i aktivitetit ekonomik është shoqëruar me përmirësimin e disa prej balancave kryesore ekonomike dhe financiare të vendit. Më konkretisht, gjatë vitit 2017 deficit i llogarisë korrente zbriti në 6,9% të prodhimit të brendshëm bruto, nga niveli 7,6% i regjistruar një vit më parë. Përmirësimi i tij reflektoi rritjen e aktivitetit turistik dhe të shërbimeve të tjera të biznesit. Treguesit fiskalë shënuan konsolidim, duke u reflektuar në një nivel të ulët të deficitit buxhetor dhe në ruajtjen e kontrollit mbi borxhin publik.

Në tregjet financiare normat e interesit mbetën të ulëta dhe treguesit e shëndetit të sistemit bankar erdhën në përmirësim. Sistemi bankar i vendit ruajti tregues të mirë likuiditeti, përmirësoi treguesit e përfutueshmërisë dhe të kapitalizimit. Në fund të vitit 2017 mjaftueshmëria e kapitalit shënoi 16,6%, duke u rritur me 0,2 pikë përqindje në krahasim me një vit më parë. Pësia e aktiveve të sektorit bankar ndaj PBB-së shënoi 92,5% në fund të vitit 2017.

Veprimtaria e sektorit bankar ka qenë e qëndrueshme dhe ka sjellë reduktimin e rreziqeve ndaj stabilitetit financiar. Në veçanti rreziku i kreditit shënoi ulje të ndjeshme gjatë këtij viti. Raporti i kredive me probleme zbriti në 13,2% në fund të vitit, duke shënuar një reduktim prej rreth 5 pikësh përqindje krahasuar me një vit më parë. Rreziku i likuiditetit në veprimtarinë bankare vijon të jetë i ulët, ndërkohë që ekspozimi i sektorit bankar ndaj rreziqeve të tregut mbetet i pranishëm dhe në monitorim nga ana jonë.

Përmirësimi i pozicionit ciklik të vendit dhe sinjalet inkurajuese për perspektivën e rritjes ekonomike kanë pasqyruar edhe rezultatet e punës së Bankës së Shqipërisë. Më lejoni të ndalem më në detaje në pikat e mëposhtme:

Aktiviteti i Bankës së Shqipërisë gjatë vitit 2017 ka qenë dhe mbetet i orientuar drejt përmirësimit të misionit dhe detyrave tona ligjore. Në aspektin operacional, për periudhën 2016-2018, ky aktivitet ka pasur si udhërrëfyes strategjinë afatmesme të zhvillimit. Dy kanë qenë drejtimet kryesore të aktivitetit tonë: politika monetare dhe mbikëqyrja e rregullimi i sektorit bankar.

Politika monetare e Bankës së Shqipërisë vijon të ruajë një karakter stimulues gjatë vitit 2017, në prani të shfrytëzimit ende jo të plotë të kapaciteteve prodhuese dhe të presioneve të dobëta inflacioniste. Stimuli monetar u transmetua nëpërmjet ruajtjes së normës bazë të interesit në nivelin e ulët historik prej 1,25% nëpërmjet rritjes së vëllimit dhe kohëzgjatjes mesatare të likuiditetit të injektuar në tregun ndërbankar, si dhe nëpërmjet orientimit të tregut mbi kahun e ardhshëm të politikës monetare.

Efektet pozitive të politikës monetare janë të prekshme në disa drejtime:

Së pari, në uljen e kostove të financimit të konsumit dhe të investimeve. Vëllimi i kredisë në lekë për sektorin privat u rrit me 7,2% në vitin 2017, duke dhënë kontributin kryesor në rritjen e kredisë totale.

Së dyti, në reduktimin e pasigurive të agjentëve ekonomikë, duke i nxitur ata drejt konsumit dhe investimit.

Së treti, në zbutjen e presioneve forcuese të kursit të këmbimit, duke ndihmuar në përmirësimin e bilancit të shkëmbimeve tregtare dhe në rritjen e mëtejshme të aktivitetit ekonomik.

Së katërti, në forcimin e stabilitetit financiar.

Ambienti financiar, me interesa të ulëta, ka ndihmuar përmirësimin e balanceve financiare të kredimarrësve nëpërmjet nxitjes së kërkesës agregate, lehtësimit të kostos së shërbimit të borxhit, si dhe inkurajimit të ristrukturimit të kredive ekzistuese.

Vlerësimet tona për impaktin e politikës monetare tregojnë se kontributi i saj në rritjen ekonomike të vendit për vitet 2015, 2016 dhe 2017 është përkatësisht rreth 0,2, 0,4 dhe 0,7 pikë përqindje.

Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar përpjekjet për përmirësimin e mekanizmit të transmetimit të politikës monetare. Gjatë vitit 2017 ne kemi punuar në tri drejtime kryesore:

Së pari, në nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare. Shkalla e lartë e euroizimit ekspozon agjentët privatë dhe sistemin financiar ndaj luhatjeve të kursit të këmbimit, si dhe vështirëson përcjelljen e politikës monetare. Për këtë arsye Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nënshkruan

memorandumin e bashkëpunimit “Për zgjerimin e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar dhe në ekonominë shqiptare”. Në këtë memorandum palët nënshkruese angazhohen për të identifikuar dhe për të ndërmarrë veprime konkrete në sferat e tyre të kompetencës. Brenda këtij kuadri, Banka e Shqipërisë identifikoi një paketë masash, të cilat, pas konsultimit me industrinë bankare, do të hyjnë në fuqi gradualisht gjatë gjysmës së dytë të vitit 2018.

Së dyti, në rritjen e gatishmërisë së bankave për të zgjeruar kreditimin. Oreksi i bankave për kreditim vijon të mbetet relativisht i ulët, duke pasqyruar efektin e dy faktorëve: së pari, politikat e reduktimit të ekspozimit ndaj vendeve të rajonit, përfshirë edhe Shqipërinë, të bankave mëma, me origjinë nga eurozona dhe, së dyti, perceptimin e rrezikut të kredisë në vend.

Për të adresuar këtë problem Banka e Shqipërisë ka vijuar bashkëpunimin me Kolegjin e Autoriteteve Bankare Europiane, me qëllim shkëmbimin e informacionit dhe harmonizimin e politikave mbikëqyrëse. Gjithashtu, Banka e Shqipërisë ka vijuar zbatimin e planit kombëtar për uljen e nivelit të kredive me probleme dhe për përmirësimin e ambientit kreditues në vend.

Së treti, në nxitjen e zhvillimit të tregjeve dhe në zgjerimin e gamës së instrumenteve financiare. Gjatë vitit 2017 Banka e Shqipërisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Banka Botërore kanë eksploruar mundësitë për zhvillimin e tregut dytësor të letrave me vlerë të qeverisë dhe për përmirësimin e funksionimit të tregut primar. Ky projekt do t’u shërbejë rritjes së tregtimit të letrave me vlerë, rritjes së bazës së investitorëve dhe administrimit më të mirë të likuiditetit.

Në drejtim të stabilitetit financiar, Banka e Shqipërisë ka vijuar punën për zbatimin e një politike mbikëqyrëse e rregullatore të kujdesshme dhe proaktive.

Gjatë vitit 2017 janë zhvilluar 14 ekzaminime të plota dhe të pjesshme në subjektet banka, jobanka, si dhe te shoqëritë e kursim-kreditit.

Ekzaminimet treguan se sektori bankar është përmirësuar në drejtim të cilësisë së politikave të brendshme dhe zbatimit të tyre, ngritjes së proceseve të përshtatshme për administrimin e rrezikut dhe zbatimit të kuadrit rregullator. Nga ana tjetër, subjektet financiare

jobanka vlerësohet se kanë ende hapësira për të siguruar efektivitetin, pavarësinë dhe autoritetin e duhur.

Praktika mbikëqyrëse ka shënuar përmirësim në drejtim të metodologjisë së kontrollit të bankave, të përafrimit të standardeve me parimet e Bazelit, si dhe të adoptimit të praktikave më të mira ndërkombëtare.

Vëmendje të veçantë kanë marrë proceset konsoliduese, si dhe planet strategjike të sistemit bankar. Po ashtu, gjatë vitit 2017 Banka e Shqipërisë përgatiti dhe miratoi strategjinë e politikës makroprudenciale, e cila do të orientojë përdorimin e instrumenteve rregullatore, në interes të forcimit të stabilitetit financiar të vendit; përgatiti kuadrin rregullator për vlerësimin e brendshëm të mjaftueshmërisë së kapitalit, i hartuar në frymën e parimeve të Bazelit dhe të direktivave të BE-së (vlerësimi i brendshëm i mjaftueshmërisë së kapitalit plotëson perspektivën mbikëqyrëse me dimensionin vetëvlerësues të bankave); bëri ndryshime të ndjeshme në procesin e parandalimit të pastrimit të parave nëpërmjet rishikimit të kuadrit rregullator përkatës; vazhdoi punën për rishikimin e metodologjisë mbikëqyrëse të vlerësimit të qeverisjes korporative të bankave, të funksionimit dhe pavarësisë së komiteteve të tyre, të strukturës së kontrollit të brendshëm në vlerësimin e rreziqeve dhe funksionimit të tyre.

Në këtë projekt ne jemi partnerë me Bankën Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim. Pavarësisht progresit të arritur në reduktimin e kredive me probleme, nuk ka munguar vëmendja për përmbytjen e objektivave vjetorë të bankave lidhur me ecurinë e kredive me probleme, si dhe me hartimin e planeve të rimëkëmbjes dhe zgjidhjes së kredimarrësve të mëdhenj. Në përmbytje të kërkesave tona, bankat raportojnë periodikisht te Banka e Shqipërisë për ecurinë e marrëdhënieve të tyre me çdo kredimarrës, si dhe pritjet e planet për zhvillimet e ardhshme.

Gjatë vitit 2017 hyri në fuqi ligji “Për rimëkëmbjen dhe ndërhyrjen e jashtëzakonshme në banka në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj e njeh Bankën e Shqipërisë si autoritetin e ndërhyrjes së jashtëzakonshme për bankat dhe degët e bankave të huaja, që ushtrojnë aktivitetin e tyre në vend. Ai përbën një tjetër hap në

drejtim të adoptimit të standardeve europiane në kuadrin rregullator të Bankës së Shqipërisë. Në zbatim të kërkesave ligjore u themelua fondi i ndërhyrjes së jashtëzakonshme, i cili do të mundësojë zbatimin e instrumenteve të ndërhyrjes së jashtëzakonshme.

Paralelisht me drejtimet e mësipërme të punës, Banka e Shqipërisë ka qenë e vëmendshme dhe ka vijuar punën në drejtim të nxitjes së zhvillimit të sistemit të pagesave; të përmirësimit të procedurave dhe të modaliteteve të administrimit të rezervës valutore; të përmirësimit të komunikimit me publikun; të thellimit të punës kërkimore shkencore; të zgjerimit dhe përmirësimit të statistikave; të rritjes së kulturës dhe përfshirjes financiare; si dhe të bashkëpunimit me institucionet vendase dhe të huaja e të tjera.

Gjej me vend të theksoj se Banka e Shqipërisë ka pasur në vëmendje jo vetëm realizimin e objektivave ligjorë, por edhe forcimin e qeverisjes së saj institucionale. Në këtë kontekst, gjatë vitit 2017 u përditësua strategjia afatmesme e zhvillimit të Bankës së Shqipërisë, si dhe u hartua dhe u miratua buxheti afatmesëm i saj. Për herë të parë shpenzimet kapitale dhe projektet e përfshira në buxhet u miratuan paraprakisht në Komitetin e Shpenzimeve Kapitale. Gjithashtu, gjatë vitit të kaluar ka vijuar punën Komiteti i Auditit, i cili ushtron një funksion monitorues të pavarur nga administrimi i Bankës së Shqipërisë.

Së fundi, gjatë vitit 2017 Këshilli Mbikëqyrës miratoi për herë të parë nivelin e tolerancës ndaj rrezikut operacional në Bankën e Shqipërisë, çka do të ndihmojë administrimin eficient të rrezikut nëpërmjet identifikimit dhe trajtimit të hershëm të tij, në përputhje me procedurat e paracaktuara.

Në tërësi politikat e ndjekura dhe masat e ndërmarra nga Banka e Shqipërisë i kanë shërbyer promovimit të stabilitetit monetar dhe financiar, duke kontribuar në ruajtjen e ekuilibrave ekonomiko-financiarë të nevojshëm për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Sikundër e thashë në fillim të fjalës sime, perspektiva e zhvillimit të vendit mbetet pozitive. Megjithatë, ne përballemi dhe do të

vazhdojmë të përballemi me sfida, të cilat duhen adresuar me kurajë, vizion dhe vendosmëri.

Me lejoni të parashtoj, në mbyllje të prezantimit, vizionin e Bankës së Shqipërisë mbi të ardhmen e ekonomisë dhe të sistemit financiar shqiptar, si dhe mbi politikatat e duhura të zhvillimit.

Perspektivat dhe sfidat e zhvillimit të vendit

Përmirësimi ciklik i ekonomisë shqiptare, i nxitur nga kushtet e favorshme të financimit, nga gjallërimi i mëtejshëm i aktivitetit ekonomik botëror, si dhe nga forcimi i besimit në ekonomi pritet të vazhdojë edhe gjatë horizontit afatmesëm të 2-3 vjetëve të ardhshëm. Rritja e kërkesës agregate do të nxitë një rritje të mëtejshme të punësimit dhe një rritje më të shpejtë të pagave. Shfrytëzimi më i plotë i kapaciteteve prodhuese do të mundësojë kthimin e inflacionit në objektiv, brenda horizontit kohor afatmesëm, dhe do të ndihmojë në përmirësimin e ekuilibrave të përgjithshëm ekonomikë dhe financiarë.

Përmbushja e këtij skenari mbetet e kushtëzuar nga mungesa e goditjeve, të brendshme apo të jashtme, mbi ekonominë apo sistemin financiar shqiptar. Gjithashtu ajo kërkon vazhdimin e kursit stimulues të politikës monetare dhe ruajtjen e kursit konsolidues të politikës fiskale. Bashkërendimi i këtyre politikave është jetik për sigurimin e një rritjeje ekonomike të qëndrueshme dhe për forcimin e stabilitetit makroekonomik të vendit. Nga njëra anë, kjo ruan një kah rezultat stimulues të politikave kryesore ekonomike dhe, nga ana tjetër, adreson dobësitë e ndryshme. Duke parë përtej horizontit afatmesëm, Banka e Shqipërisë vlerëson se ka ende mjaft punë për të bërë në drejtim të forcimit të ritmit të rritjes ekonomike dhe të rritjes së rezistencës së ekonomisë shqiptare ndaj goditjeve.

Politika monetare stimuluese ofron një ndihmë në këtë drejtim, por ajo nuk mund të zëvendësojë reformat e nevojshme strukturore për përmirësimin dhe funksionimin tërësor të ekonomisë shqiptare. Në gjykimin tonë, këto reforma strukturore duhet të adresojnë: përmirësimin e mëtejshëm të klimës së biznesit nëpërmjet vijimit të masave për uljen e informalitetit dhe promovimin e konkurrencës së ndershme, nëpërmjet përmirësimit dhe

harmonizimit të gjithanshëm të kuadrit ligjor dhe të procesit të zbatimit të ligjit, si dhe nëpërmjet uljes së burokracisë dhe të përmirësimit të funksionimit të administratës publike. Përmirësimi i klimës së biznesit është esencial për tërheqjen e investimeve të huaja dhe nxitjen e investimeve vendase; zgjerimin e tregjeve për produktet shqiptare nëpërmjet promovimit të markës së produkteve shqiptare nxitjes së integritimit rajonal, si dhe përshpejtimit të procesit të integritimit europian; rritjen e eficiencës së ekonomisë shqiptare nëpërmjet investimeve të mëtejshme në infrastrukturë, arsim dhe shëndetësi, nëpërmjet inkurajimit të rritjes së shkallës së pjesëmarrjes në forcat e punës, si dhe nëpërmjet përmirësimit të standardeve të administrimit të biznesit.

Rritja e eficiencës në ekonomi nënkupton norma më të larta rritjeje ekonomike dhe standarde më të larta mirëqenieje për shoqërinë shqiptare; rritjen e fleksibilitetit dhe rezistencës së ekonomisë shqiptare nëpërmjet inkurajimit të procesit të ristrukturimit të ndërmarrjeve, nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të arkitekturës së mbikëqyrjes dhe rregullimit të sistemit financiar, si dhe nëpërmjet rritjes së kujdesit ndaj treguesve të borxhit publik dhe privat (një ekonomi më rezistente dhe elastike përballon më lehtë goditjet dhe riorientohet më shpejt ndaj oportuniteteve të zhvillimit); zgjerimin dhe diversifikimin e mëtejshëm të tregjeve financiare, duke punuar paralelisht për rritjen e kursimeve në ekonominë shqiptare, për zhvillimin e studiuar të segmenteve të tjera të tregut financiar, si dhe për prezantimin e kujdesshëm të produkteve të reja dhe instrumenteve të reja financiare.

Zhvillimi dhe diversifikimi i tregjeve financiare përmirëson aksesin në financë, duke rritur bazën e sipërmarrësve potencialë, si dhe duke mundësuar një administrim më të mirë të financave personale. Gjithashtu, ai përmirëson strukturën e financimit të ekonomisë shqiptare dhe i hap rrugë zhvillimit të vendit në një të ardhme jo të largët, ku potencialisht roli i bankave dhe i industrisë bankare do të jetë më i reduktuar.

Banka e Shqipërisë gjykon se procesi i integritimit europian duhet të jetë *ankora* orientuese e të gjitha politikave të zhvillimit të vendit. Ndjekja e këtij objektivit kërkon

bashkëpunimin dhe energjitë e të gjithë aktorëve të përfshirë në proces, duke nënkuptuar vullnetin e tyre për të përballuar kostot e politikave dhe të reformave të nevojshme për integrimin e vendit.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Në përfundim të fjalës sime, dua t'ju siguroj se Banka e Shqipërisë do të vijojë të mbetet e përkushtuar për respektimin e objektivave të saj ligjorë, si dhe për zbatimin e detyrave dhe angazhimeve të saja institucionale.

Ju faleminderit për vëmendjen!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Sejko!

Pyetje nuk janë depozituar. Kërkesë për debat nuk ka. Në fund të seancës do të votohet rezoluta.

Faleminderit!

Vazhdojmë me raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimeve të Depozitave për vitin 2017.

Ftoj zotin Genci Mamani, drejtorin e Përgjithshëm, për të paraqitur raportin para parlamentit.

Genci Mamani – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Fillimisht dua t'ju falënderoj, në emër të Agjencisë së Sigurimeve të Depozitave, për bashkëpunimin e frytshëm dhe kontributin e Kuvendit të Shqipërisë në drejtim të përmirësimit të mëtejshëm të skemës së sigurimit të depozitave dhe mbështetjes së dhënë për projektet kryesore të agjencisë! Ashtu sikurse edhe në vitet e mëparshme, viti i kaluar ka qenë një vit pozitiv në aktivitetin e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave, në të cilin nuk ka pasur asnjë ngjarje sigurimi. Pavarësisht kësaj, ne si Agjenci, kemi qenë dhe vazhdojmë të jemi të angazhuar për të qenë gati në çdo kohë për të përmbushur mandatin tonë ligjor. Për këtë qëllim kemi punuar intensivisht për të rritur gatishmërinë operacionale të institucionit për përballimin e situatave, që do të kërkonin ndërhyrjen e Agjencisë apo ngjarjeve të sigurimit, që mund të ndikojnë në sistemin bankar dhe financiar.

Si fillim, para se t'ju prezantoj një përmbledhje të aktiviteteve të Agjencisë përgjatë vitit në raportim dhe një pasqyrë të skemës së sigurimit të depozitave, më lejoni të sjell në vëmendjen tuaj rekomandimet e

rezolutës së fundit të Kuvendit për veprimtarinë e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave dhe veprimet konkrete të Agjencisë për vënien në zbatim të tyre.

Në lidhje me rekomandimin e parë, i cili parashikonte se agjencia duhet të zhvillojë më tej skemën e sigurimit të depozitave dhe të identifikojë fushat e mundshme të përmirësimit për të rritur efektivitetin dhe gatishmërinë në rast ngjarje sigurimi, kemi ndërmarrë nismën ligjore për përfshirjen e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në skemën e sigurimit të depozitave. Kjo nismë ligjore u finalizua me miratimin nga Kuvendi i Shqipërisë të ligjit nr. 39/2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.83 /2014, datë 22.05.2014 “Për sigurimin e depozitave””. Miratimi i këtij ligji mundësoi rritjen e bazës së depozituesve të mbrojtur nga skema e sigurimit të depozitave, duke kontribuar në forcimin e stabilitetit financiar në Republikën e Shqipërisë.

Anëtarësimi në skemë i shoqërive të kursim-kreditit, si dhe përfshirja e depozitave të tregtarëve dhe shoqërive tregtare në depozitat e sigurueshme hyri në fuqi më 1 janar 2017.

Rekomandimi i dytë përcaktonte që Agjencia duhet të asistojë në procesin e përgatitjes së shoqërive të kursim-kreditit, për përmbushjen nga ana e tyre të kriterëve të kërkuara, me qëllim përfshirjen e tyre të njëkohshme në skemën e sigurimit të depozitave, si dhe të vendosë informacion për shoqëritë e kursim-kreditit në faqen *online* të Agjencisë.

Në zbatim të ligjit, si dhe në përputhje me këtë rekomandim të Kuvendit të Shqipërisë, Agjencia u angazhua seriozisht në takime konsultuese dhe informuese me përfaqësues të të gjitha shoqërive të kursim-kreditit. Këto takime synonin përgatitjen e shoqërive të kursim-kreditit për të qenë në përputhje me kërkesat ligjore për anëtarësim në skemë.

Më pas, Agjencia, në bashkëpunim të ngushtë me Bankën e Shqipërisë, kreu disa raunde verifikimesh në të gjitha shoqëritë e kursim-kreditit, që kishin aplikuar për anëtarësim në skemë. Në raportet e verifikimit u lanë rekomandime, me qëllim përmirësimin e punës për plotësimin e kërkesave për anëtarësim në skemë. Në vijim të gjithë këtij procesi, në vitin 2016 u përfshinë 5 shoqëri kursim-krediti në skemën e sigurimit të depozitave, ndërsa në vitin

2017 u krijua një tjetër shoqëri kursim-krediti, çka e çoi në 6 numrin total të shoqërive të kursim-kreditit të anëtarësuar.

Në kuadër të rekomandimit, që Agjencia duhet të përmirësojë në vazhdimësi infrastrukturën e saj informatike për t’iu përgjigjur në kohë dhe saktë depozituesve në rast të një ngjarjeje sigurimi, ju informoj se, duke filluar nga data 1 janar 2017, Sistemi Informatik për Raportim dhe Kompensim (SIRK) u përshtat për raportimin elektronik të të dhënave. Ky sistem mundëson raportimin në një platformë të sigurt të të dhënave për depozitat e tregtarëve dhe shoqërive tregtare nga bankat dhe/ose shoqëritë e kursim-kreditit për përllogaritjen e primit dhe shumës së depozitave të siguruar, me qëllim pagesën në kohë dhe saktë të depozituesve në rast ngjarjeje sigurimi.

Sipas rekomandimit tjetër të radhës, kërkohet që Agjencia të angazhohet në administrimin efikas të mjeteve financiare dhe gjetjen e mënyrave alternative të investimit në kushtet kur normat e letrave me vlerë të qeverisë janë në rënie.

Në lidhje me këtë rekomandim, me qëllim rritjen e efikasitetit në administrimin e mjeteve financiare, janë miratuar akte rregullative, të cilat synojnë, ndër të tjera, ndarjen e qartë midis funksioneve zbatuese dhe monitoruese, rishikimin dhe zgjerimin e funksioneve të Komitetit të Investimeve, duke përfshirë përshtatjen e strategjisë së administrimit të mjeteve financiare në përputhje me vlerësimet e rrezikut, që kanë subjektet anëtare dhe strukturimin e portofolit në transhe për të respektuar parimet e likuiditetit dhe sigurisë.

Në kuadër të aktivitetit investues dhe zhvillimeve në tregun e letrave me vlerë, Agjencia, në përputhje me dispozitat ligjore, ka diversifikuar portofolin duke synuar një shpërndarje përpjestimore midis maturiteteve.

Rekomandimi i radhës i kërkon Agjencisë të jetë e vëmendshme ndaj zhvillimeve në sistemin bankar dhe financiar në vend, të zhvillojë maksimalisht kapacitetet për t’iu përgjigjur situatave të mundshme, që do të kërkonin ndërhyrjen e Agjencisë.

Ju informoj se Agjencia e Sigurimit të Depozitave është në çdo kohë mjaft e angazhuar dhe vigjilente ndaj zhvillimeve në sistemin bankar dhe financiar dhe ka ngritur linja të

rregullta raportimi me subjektet anëtare dhe Bankën e Shqipërisë duke krijuar një bazë të dhënash të mjaftueshme për një vlerësim të rrezikut të sistemit bankar.

Gjatë vitit 2017 Agjencia realizoi për herë të parë procesin e përzgjedhjes së bankave agjente në listën paraprake, e cila përfundoi me nënshkrimin e kontratave me tri banka të sistemit. Ky proces është një hap konkret në drejtim të përfundimit të kapaciteteve të Agjencisë për përmbytjen e objektivave të saj ligjore, pasi banka agjente do të ketë rol kyç në realizimin e një procesi të shpejtë dhe të saktë kompensimi.

Gjithashtu, në këtë kuadër gjej rastin të ndaj me ju edhe angazhimin e Agjencisë në ligjin për ndërhyrjen e jashtëzakonshme, ku Agjencia është ngarkuar me rolin e administratorit të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Ky mekanizëm, i krijuar nga Banka e Shqipërisë, në rolin e autoritetit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, por dhe me bashkëpunimin e vazhdueshëm gjatë gjithë etapave nga Agjencia, krijon një mbrojtje më shumë për depozituesit në rast të situatave të papëlqyeshme në sistemin bankar.

Rekomandimi i fundit i rezolutës parashikon që Agjencia duhet të promovojë në mënyrë të vazhdueshme skemën e sigurimit të depozitave, si dhe të rrisë nivelin e edukimit dhe ndërgjegjësimit të depozituesve për përfitimet dhe kufizimet e skemës së sigurimit të depozitave.

Së fundi, në lidhje me këtë rekomandim dëshiroj t'ju informoj se kemi hartuar politika të ndërgjegjësimit të publikut, si dhe janë kryer trajnime të punonjësve të bankave dhe të shoqërive të kursim-kreditit. Bazuar në këto politika, jemi munduar të përdorim me sa më shumë efektivitet mjetet e ndryshme dhe kanalet e komunikimit në dispozicion.

Gjithashtu, kemi bashkëpunuar dhe koordinuar me Bankën e Shqipërisë dhe Shoqatën Shqiptare të Bankave në organizimin e aktiviteteve edukuese dhe ndërgjegjësuere me fokus edukimin financiar dhe rritjen e besimit të publikut.

Këto ishin edhe rekomandimet e dhëna nga Rezoluta e Kuvendit dhe hapat e ndërmarrë nga Agjencia për plotësimin e tyre, të cilat përbëjnë

edhe pjesën më të rëndësishme të aktivitetit tonë në këto vite.

Në vijim, do të dëshiroja të sillja në vëmendjen tuaj një përmbledhje të treguesve kryesorë të depozitave në sistemin bankar dhe të skemës së sigurimit të depozitave në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2017 sistemi bankar shqiptar vazhdoi të mbetet i shëndetshëm e me një ecuri pozitive, duke ofruar siguri e duke gëzuar besimin e klientëve shqiptarë dhe të huaj. Depozitat e sistemit bankar në fund të vitit 2017 janë rritur me rreth 0.08% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2016. Pra, më 31 dhjetor 2017 totali i depozitave të sistemit bankar rezulton të jetë rreth 1,115 miliardë lekë.

Në fund të vitit 2017, vlera e depozitave të sigurueshme, që do të thotë depozita, të cilat ligji i klasifikon si të lejuara për t'u siguruar, arriti 1,074 miliardë lekë, duke përfaqësuar 96,3% të totalit të depozitave.

Si rezultat i zgjerimit me depozitat e tregtarëve dhe shoqërive tregtare, rritja vjetore e depozitave të sigurueshme në vlerë ishte 161 miliardë lekë ose 17,6% më shumë se një vit më parë. Në totalin e depozitave të sigurueshme depozitat në valutë shfaqin një epërsi të lehtë me rreth 51%.

Në fund të dhjetorit 2017, numri i depozituesve me balancë të agreguar më të vogël ose të barabartë me 2,500.000 lekë përfaqëson 94% të totalit të depozituesve që përfitojnë nga skema dhe në vlerë 407 miliardë lekë, që përfaqëson 38% të totalit të depozitave të sigurueshme.

Numri i depozituesve me balancë të agreguar më të madhe se 2,500.000 lekë përfaqëson 6% të totalit të depozituesve, në vlerë rreth 667 miliardë lekë ose 62% e totalit të depozitave të sigurueshme.

Ashtu siç kemi theksuar edhe më lart, viti 2017 ka qenë edhe viti i parë i raportimit të shoqërive të kursim-kreditit, pjesë e skemës të sigurimit të depozitave. Totali i depozitave të shoqërive të kursim-kreditit në fund të vitit 2017 arriti në 6.1 miliardë lekë nga 4.1 miliardë lekë që ishte në fund të dhjetorit 2016, duke shënuar një rritje vjetore prej 48,7%. Depozitat e sigurueshme të shoqërive të kursim-kreditit në fund të dhjetorit 2017 janë 6 miliardë lekë dhe përfaqësojnë 98,6% të totalit të depozitave.

Në fund të vitit 2017, përfitues ishin 19,543 depozitues të shoqërive të kursim-kreditit, kundrejt 5,879 depozituesve në fillim të këtij viti. Kjo rritje e ndjeshme ka ardhur jo vetëm si rezultat i zgjerimit të aktivitetit të shoqërive ekzistuese të kursim-kreditit dhe të rritjes së besueshmërisë së publikut në këto shoqëri pas përfshirjes së tyre në skemë, por edhe si rezultat i përfshirjes në skemë të njëjtë të të gjitha shoqërive të kursim-kreditit.

Performanca financiare e Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017 është karakterizuar nga një rritje e qëndrueshme e fondit të sigurimit të depozitave në banka. Krahësuar me një vit më parë, fondi i sigurimit të depozitave në banka, u rrit me 12,08 % duke kapur një vlerë prej 35,017 miliardë lekësh më 31 dhjetor 2017. Të ardhurat nga primet e sigurimit për vitin 2017 ishin 3,2 miliardë lekë ose 7,17% më të larta se në vitin 2016.

Nga ana tjetër, të ardhurat nga administrimi i mjeteve financiare të fondit të sigurimit të depozitave në banka, për vitin 2017, ishin 780,2 milionë lekë. Këto të ardhura janë ndikuar nga dinamika e normave të interesit të letrave me vlerë të qeverisë shqiptare.

Rritja e fondit të sigurimit të depozitave dhe ecuria e depozitave të siguruara në sistemin bankar gjatë vitit 2017 kanë sjellë një rritje të raportit të mbulimit. Raporti i mbulimit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave, në krahasim me depozitat e siguruara, shkoi nga 5.11% në fund të vitit 2016 në 5.34% në fund të vitit 2017. Ecuria pozitive e këtij raporti është tregues i rëndësishëm për efikasitetin e skemës së sigurimit të depozitave dhe një garanci më e madhe për depozituesit.

Sa i takon fondit të sigurimit të depozitave të shoqërive të kursim-kreditit, më 31 dhjetor 2017 vlera kontabël e këtij fondi ishte 92,2 milionë lekë, duke shënuar një rritje prej 19,5% krahasuar me vitin 2016.

Raporti i mbulimit në shoqëritë e kursim-kreditit, i llogaritur si përqindje e fondit të sigurimit të depozitave, në krahasim me depozitat e siguruara, ishte 2,05% në fund të vitit 2017.

I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit,

Të nderuara zonja dhe zotërinj deputetë,

Këto ishin disa nga projektet dhe treguesit kryesorë të institucionit gjatë vitit 2017.

Ndërkohë, ju shpreh angazhimin tonë për të vazhduar punën në përmbushje të mandatit ligjor të Agjencisë. Synimi ynë është që edhe në vitin në vijim të kontribuojmë pozitivisht në stabilitetin e sistemit bankar dhe financiar në vend, duke rritur besimin e qytetarëve në të.

Ky angazhim yni përkon me bashkëpunimin e ngushtë me partnerët tanë vendas dhe të huaj, për të përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme skemën e sigurimit të depozitave në Shqipëri, në përputhje me standardet e pranuar ndërkombëtare në këtë fushë.

Ju falënderoj për vëmendjen!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Genti!

Pyetje të depozituara nuk ka. Kërkesë për të zhvilluar debat nuk ka. Rezoluta do të votohet në fund sipas procedurave parlamentare.

Faleminderit!

Vazhdojmë me projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve””.

A do të shprehet nismëtar? Jo.

A do të shprehet komisioni përgjegjës? Jo.

A do të shprehet relatori? Jo.

Për këtë projektligj nga Partia Socialiste janë regjistruar për të diskutuar deputetët: Taulant Balla, Vasilika Hysi, Elisa Spiropali, Alket Hyseni, Klotilda Bushka, Ermonela Felaj, Ulsi Manja, Eduard Shalsi, Ilir Beqaj, Evis Kushi, Vilma Bello, Ervin Bushati, Milva Ekonomi, Adnor Shameti; nga Partia Demokratike deputetët: Lulzim Basha, Sali Berisha, Edmond Spaho, Edi Paloka, Albana Vokshi, Oerd Bylykbashi, Gent Strazimiri, Fatmir Mediu, Flamur Noka, Jorida Tabaku, Ervin Salianji, Tritan Shehu, Florion Mima, Grida Duma, Genc Pollo, Bardh Spahia, Aldo Bumçi, Dashamir Shehi, Endrit Hasa, Fatbardha Kadiu, Halim Kosova, Hekuran Haxholli, Isuf Çelaj, Izmir Ulqinaku, Klevis Balliu, Lindita Metaliaj, Lorenc Luka, Luan Baçi, Luçiano Boçi, Myslim Murrizi, Nadire Meçorapaj, Nard Ndoka, Orjola Pampuri, Romeo Gurakuqi, Rudina Hajdari, Valentina Duka, Vangjel Dule dhe Xhemal Gjunkshi.

Nga Lëvizja Socialiste për Integritet deputetët: Luan Rama, Petrit Vasili, Monika Kryemadhi, Nasip Naço, Silva Caka dhe Endrit Braimllari.

Në emër të grupeve: Enkelejd Alibeaj dhe Bledar Çuçi.

Fillojmë me diskutimet për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve””.

Fjalën e ka zoti Basha.

Lulzim Basha - Zonja dhe zotërinj,

Të dashur bashkëqytetarë,

Sot Fatmir Xhafaj duhej të ishte shkarkuar nga detyra e ministrit të Brendshëm. Sot Agron Xhafaj duhej të ishte në arrest këtu, në Shqipëri, dhe nën hetim nga prokuroria. Sot pasuritë e familjes Xhafaj duhej të ishin nën hetim, sipas ligjit antimafia, por dje Agron Xhafaj është përcjellë me ngut për në Itali fshehtazi dhe me urgjencë, ndërsa Edi Rama dhe Fatmir Xhafaj janë të zënë me një punë tjetër; se me çfarë, do ta marrim vesh shumë shpejt.

Prej 9 ditësh shqiptarët dhe opinioni ndërkombëtar kanë parë dhe dëgjuar fakte të pranuar edhe nga vetë Fatmir Xhafaj. Fakti se Agron Xhafaj u kap në një operacion ndërkombëtar ndaj një organizate kriminale të trafikut të drogës, i zhvilluar nga policia italiane dhe DEA (Agjencia Amerikane e Luftës Kundër Drogës) u mohua për vite me radhë, por u pranua këtë javë edhe nga vetë Fatmir Xhafaj.

Fakti se Agron Xhafaj është dënuar në Itali me vendim të formës së prerë, e konfirmuar nga Gjykata e Lartë italiane, me 7 vjet e 2 muaj heqje lirie, për pjesëmarrje në një grup të strukturuar kriminal, që kryente trafik ndërkombëtar droge, u mohua për 5 vjet me radhë dhe u pranua sot. Është fakt që Agron Xhafaj i ka ikur gjithë këta vjet drejtësisë, se ai ka pasur dijeni të plotë për të gjitha proceset, ka pasur avokat, që e ka pajtuar vetë, por ka vendosur t’i iki dhe t’i bëjë bisht drejtësisë gjatë gjithë procesit të gjyimit dhe të dënimit dhe më pas, pas vuajtjes së dënimit.

Është fakt që Agron Xhafaj nuk ka vuajtur asnjë ditë dënim, as në Itali, ku është dënuar dhe as në Shqipëri. Është fakt se deri para dy ditësh, deri dje, Agron Xhafaj ishte në Shqipëri, ishte në Vlorë. Është fakt se Agron Xhafaj e ndërroi identitetin e tij nga Agron në Geron. Është fakt i parë me zë dhe me figurë se Agron apo Geroni vazhdonte aktivitetin e tij kriminal të trafikut të drogës në qytetin e Vlorës. Nëntë ditë pa asnjë përgjigje, nëntë ditë pa asnjë qëndrim dhe dje, papritur, Agron Xhafaj niset fshehtazi dhe me

urgjencë për në Itali, jo siç ekstradohen të dënuarit me pranga në duar dhe të shoqëruar nga autoritetet, por me avionin e linjës, ku, natyrisht, as nuk ia vunë prangat dhe as nuk kryen procedurat, por u përshëndet në qetësi me policët dhe u ngjit në avion.

Pesë vjet pa i hyrë gjemb në këmbë dhe papritur, pasi u publikuan faktet, që e konfirmuan si kokën e krimit të organizuar në Vlorë, përcillet me nderime dhe me mallëngjim të shtirë për në Itali. Çfarë fshihet pas kësaj ngjarjeje? Çfarë fshihet pas kësaj ngutjeje? Policia duhet ta kishte ndaluar, prokuroria duhej të kishte nisur urgjent hetimin, por policia ka marrë një tjetër urdhër këto 72 orë nga vëllezërit Xhafaj. Prej 72 orësh dëshmitari X dhe familja e tij janë nën presionin e tmerrshëm, të dyfishtë të bandës dhe bandave Xhafaj dhe nën presionin dhe terrorin policor. E gjithë policia është vënë pas familjes së dëshmitarit dhe pas vetë dëshmitarit. Policia e kishte për detyrë me ligj ta ndalonte Agron Xhafajn pas përgjimit që tregoi me zë dhe figurë, se është dhe mbetet koka e drogës në Vlorë. Prokuroria e ka për detyrë të hapë hetimin, në një vend normal, sigurisht, por kanë bërë diçka tjetër, terror policor, operacion të gjerë të shtrirë në mbarë Shqipërinë ndaj dëshmitarit X dhe familjes së tij, e gjithë policia.

Do të shtroj disa pyetje, të cilave, natyrisht, nuk u japin dot përgjigje, prandaj mungojnë. Nëse siç pretendon kryeprokurori, kryegjykatësi, Kryeministri, kryeredaktori, kryeoligarku Rama, se audiopërgjimi nuk është i vërtetë, pse i janë vënë prapa dëshmitarit X dhe familjes së tij? Çfarë nguti kanë? Pse i janë vënë prapa dëshmitarit X dhe jo bandave që po e terrorizojnë atë dhe familjen e tij paralelisht me terrorin dhe presionin policor? Nga e di policia e Xhafajt dhe ky polici këtu...

Gramoz Ruçi – Ju lutem, mos ndërhyni!

Lulzim Basha - ... të thyejë rendin e ditës duke folur nga vendi. Nga e dinë këta...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Koha për t’u shqetësuar ti, nuk ka ardhur akoma. Ti thur ëndrra për momentin, por ajo kohë nuk ka ardhur akoma.

Pra, nëse nuk do të ishte e vërtetë, siç pretendoi Edi Rama...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Mark Frroku e njoftoi? Do të mbash përgjegjësi për këtë deklaratë në prokurori!

Shpërqendrim nuk ka...

Gramoz Ruçi – Zoti Balla, ju lutem, mos ndërhyini nga vendi!

Lulzim Basha – Nuk ka rregull, rregulli i vetëm është t’iu mbyllet goja opozitës dhe dëshmitarëve.

Pra, në qoftë se nuk do të ishte e vërtetë, siç deklaroi kryegjyqtari, kryeprokurori dhe kryeeksperti Edi Rama, që me siguri ekspertizën ia ka bërë në Surrel, pse i janë vënë prapa dëshmitarit X dhe familjes së tij? Pse? Pyetja më e rëndësishme është kjo: nga e dinte...

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Mos i shko prapa pëllitjes se e bëjnë për të zhurmuar këtë pyetje. Po i kthehem prapë: nga e dinte policia e Xhafajt se kush është dëshmitari X? Nga e dinin ata kush është ky me audiopërgjimin që qenka i falsifikuar dhe i manipuluar? Nga e dinin? Kush jua tha? Jua thanë Xhafajt, jua tha vëllai i madh dhe vëllai i vogël, sepse ata e dinë fare mirë kush është dëshmitari X. E dinë fare mirë, sepse gjithçka në atë bisedë është e vërtetë, por shteti nuk vepron. Kamikazët, ndjesë, kamikazet Marku dhe Prela, nuk veprojnë, se për këtë punë janë aty. Agron Xhafaj ka emëruar shefat e policisë nëpërmjet Fatmir Xhafajt, duke filluar nga Drejtori i Përgjithshëm Ardi Veliu dhe shefat e Vlorës. Fatmir Xhafaj së bashku me Edi Ramën kanë emëruar kamikazët e tyre në krye të Prokurorisë së Përgjithshme dhe në krye të Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

Jo rastësisht kjo e fundit ndodhi ditën kur nisi denoncimi i skandalit “Xhafaj”. Jo, as Xhafaj në arrest, as Fatmiri nuk shkarkohet, shteti i Edi Ramës ka një detyrë tjetër, të gjejë dhe t’i mbyllë gojën dëshmitarit X, t’i mbyllë gojën opozitës me kërcënime dhe ndjekje penale. Shqipëria ka gati 5 vjet që harxhon të gjitha energjitë e saj për t’u mbrojtur nga krimi dhe kriminelët e Ramës. Madje përpjekjet e opozitës dhe të të gjithë shqiptarëve të ndershëm janë penguar dhe luftuar nga vetë...

(Diskutime nga salla pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Ju lutem, IT-ja hapeni mikrofonin 1 minutë!

1 minutë, zoti Basha.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Jo, nuk jepen minuta.

Lulzim Basha – Pjesën tjetër të deklaratës në facebook.

Gramoz Ruçi – Mund të vazhdoni edhe 1 minutë, zoti Basha.

Lulzim Basha – I ftoj mediet të kalojnë direkt në facebook-un e Partisë Demokratike dhe në facebook-un tim personal për të ndjekur atë që shoku Gramoz nuk do që të dëgjohet sot.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Parlamentin peng e ke marrë ti dhe kriminelët e tu dhe të Edi Ramës, ne jemi këtu për ta çliruar.

(Ndërhyrje nga salla pa mikrofon)

Gramoz Ruçi – Zoti Balla, mos ndërhyini!

Zoti Basha, po ju mbaron minuta shtesë që ju dhashë!

Koha mbaroi, uluni zoti Basha!

Zoti Basha, jua dhashë fjalën, edhe pse nuk folët asnjë fjalë për ligjin për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Fjala juaj ishte ose një interpelancë, që nuk e ke kërkuar, ose totalisht 10 minuta jashtë çështjes që po diskutojmë. Ju duhet të respektoni Kuvendin, duhet të respektoni jo pak, por 59 folës, që janë regjistruar për këtë projektligj, që do të thotë 590 minuta ose 10 orë. Parlamenti nuk është që ta uzurponi ju, prandaj ju lutem, uluni!

Fjala për procedurë zotit Basha, 2 minuta.

Lulzim Basha - Ditën që ky parlament nuk u kompozua nga vota e lirë e shqiptarëve, por nga paratë e drogës e të krimit të Agron Xhafajt, Sajmir Tahirit, të Balilajve, Habilajve me shokë, ka humbur çdo legjitimitet dhe gjithçka që bëni ju këtu jo vetëm dëmton drejtpërdrejtë interesat e shqiptarëve, përmes akteve që gllabërojnë pasuritë e tyre dhe varfërojnë shqiptarët ditë për ditë, por ka për qëllim pikërisht t’i mbyllë gojën opozitës.

Gramoz Ruçi, tani po të them, gojën opozitës nuk ke për t’ia mbyllur dot, as ti, as Edi Rama, as Fatmir Xhafaj, as me metodat e vjetra të Sigurimit të Shtetit, ku jeni shkolluar dhe rritur, as me metodat e reja, me të cilat ju kanë mësuar ata për të cilët paguani milionat e drogës. Prandaj, unë do ta vazhdoj deri në fund fjalën time këtu për çështjen e vetme që ka ky parlament, po të ishte parlament, dhe në qoftë se do të japësh kontributin tënd, do të më lejosh të mbaroj fjalën deri në fund. Në qoftë se do të vazhdosh, dhe nuk kam asnjë dyshim që atë do të bësh, ritualin e ndaljes së fjalës së opozitës për çështjen më të rëndësishme që ka sot Shqipëria dhe një nga skandalet më të mëdha që po ndjek

Europa, atëherë, pa dyshim, unë do të vazhdoj me mjetet, që, falë Zotit, as Sigurimi i Shtetit dhe askush tjetër nuk mund të na i pengojë për të komunikuar me qytetarët.

Zgjidh dhe merr!

Gramoz Ruçi - Zoti Basha, nuk është në dorën time që të zgjedh dhe të marr. Në dorën time është të zbatoj Rregulloren e Kuvendit. Nuk është në dorën time t'i mbyll gojën opozitës, përkundrazi, është e drejta e opozitës të marrë fjalën. Opozita nuk është vetëm një zë, siç je ti, lideri i opozitës, por të gjithë emrat e deputetëve që ju keni regjistruar. Nuk i kam regjistruar unë, janë 39 veta, që bëjnë 390 minuta ose afërsisht 6 orë e gjysmë diskutime.

Jam këtu bashkë me gjithë publikun të dëgjojmë 6 orë e gjysmë të gjithë diskutantët e opozitës suaj. Nuk po llogaris edhe 1 orë diskutime të opozitës tjetër, Lëvizjes Socialiste për Integritet. Pra, gjithsej, i thonë 7 orë vetëm për një projektligj.

Edhe opinioni publik po pret të dëgjoj fjalën e të gjithë kolegëve opozitarë, që kanë regjistruar emrat për të folur.

Kjo nuk është mbyllje goje, përkundrazi, është zbatim i rregullave normale në një parlament normal. Në qoftë se ju doni të krijoni ritualin tuaj për të dhënë mesazhin e Sofjes, që këtu nuk ka normalitet politik, kjo është puna juaj, taktika dhe strategjia juaj. Nuk do të jetë një lajm i mirë për Shqipërinë, por sigurisht do të keni edhe përgjegjësinë përkatëse për këtë çështje.

Ndaj, ju lutem, uluni, që të vazhdojnë diskutimet edhe kolegët e tjerë të opozitës. Zoti Berisha mezi po pret të marrë fjalën.

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Mos e pengo zotin Berisha të marrë fjalën, se është i dyti pas jush!

(Ndërhyje nga salla pa mikrofon)

Ju lutem, uluni!

Ndërpritet seanca! 10 minuta pushim!

(Rifillon seanca.)

Gramoz Ruçi - Zoti Basha, ju lutem, uluni që të vazhdojmë seancën normalisht, pasi kolegët presin të marrin fjalën! Lirojeni foltoren!

Fillojmë seancën.

(Diskutime pa mikrofon)

Zoti Basha, e fillove fjalimin nga e para!

Edhe një herë ju paralajmëroj, zoti Basha, mos më detyroni të aplikoj nenet e Rregullores për liderin e opozitës!

Radhën e kanë kolegët e tjerë deputetë, zoti Basha!

Ju tërheq vëmendjen, zoti Basha, për uzurpim të foltores!

Nuk dua të vazhdoj me masa të tjera, ndaj edhe një herë e ndërpres seancën për 10 minuta, duke të tërhequr vëmendjen, sipas Rregullores së Kuvendit, zoti Basha!

(Rifillon seanca.)

(Ndërkohë opozita është larguar nga salla.)

Gramoz Ruçi - Atëherë, rifillojmë seancën!

Vazhdojmë me diskutimet sipas radhës!

Fjalën e ka zoti Balla!

Taulant Balla - Faleminderit, zoti Kryetar!

Sot është data 17 maj 2018. Ka kaluar një vit që nga marrëveshja ndërmjet PS-së dhe PD-së, ndërmjet Kryeministrit Rama dhe kryetarit të opozitës, Basha, e cila bëri të mundur që opozita të merrte pjesë në zgjedhje, që opozita të kishte gjysmën e qeverisë (portofolët më të rëndësishëm të saj), për të kaluar në një proces zgjedhor, i cili nga OSBE-ODIHR-i dhe nga të gjithë partnerët monitorues u konsiderua si procesi zgjedhor më i mirë i zhvilluar në Shqipëri në 27 vjet.

Megjithatë, Lulzim Basha përsëri sot deklaroi të njëjtat gjëra, që prej vitit 2013, kur është bërë kryetar i PD-së.

Ju kujtoj se përmes asaj marrëveshjeje Dritan Demiraj mbajti pozicionin e ministrit të Brendshëm për 5 muaj me radhë. Pas gjithë këtyre fjalëve, ankesave, që Lulzim Basha thotë sot, si ka mundësi që Dritan Demiraj nuk bëri asgjë, nëse do të kishte ekzistuar ndonjëherë, ndonjë urdhër arresti për Agron Xhafajn?

Ministri i Brendshëm i Bashës nuk e ekzekutoi asnjëherë, për 5 muaj me radhë, këtë urdhër para një viti, kur ishte emëruar ministër i Brendshëm nga Lulzim Basha.

Kjo është një prej shumë të vërtetave, të cilat i duhen thënë publikut dhe që e sqarojnë tërësisht se e gjithë kjo zallamahi e krijuar, nuk ka të bëjë me të vërtetën, por ka të bëjë me një hall të madh të PD-së dhe personalisht të Lulzim Bashës.

Nuk paska gjë më të pamoralshme për një opozitë sesa kjo që ajo po bën, duke u përpjekur me mish e me shpirt të pengojë me çdo mënyrë hapjen e negociatave të integritetit.

Një pjesë e deputetëve të PD-së sot hynë me miell në sallë. Unë i falënderoj që nuk ia bënë Shqipërisë dëmin e radhës në imazhin e saj, në një kohë kur në një vijë ajrore prej disa qindra kilometrash prej këtu, kryeministrat e Ballkanit, së bashku me ata të vendeve anëtare të BE-së, janë në Samitin e Sofjes, i cili ka të bëjë pikërisht me dritën jeshile, që BE-ja synon t'ia hapë Ballkanit Perëndimor në samitin e 28 qershorit.

I falënderoj deputetët e PD-së, që nuk e bënë pis përsëri këtë aulë të shenjtë të demokracisë shqiptare!

Megjithatë, Lulzim Basha po u bën dëm çdo ditë interesave të Shqipërisë në këtë proces.

Dua t'u them të gjithë deputetëve dhe publikut se ajo që ka bërë PD-ja dje është e turpshme. Në mënyrë të pavërtetë, me *breaking news*, sipas tyre, informonte të gjithë deputetët e Bundestagut, të gjithë deputetët e Parlamentit Europian, se gjoja ministri i Brendshëm i Shqipërisë qenka kapoja i familjes më të madhe të narkotrafikut në Europë. E turpshme!

Ndërkohë, sot, PD-ja nuk i lejon 2 deputetët e vet (që janë akuzuesit), të bëjnë detyrën sipas ligjit, duke u paraqitur në prokurori për të thënë gjithçka dinë mbi një kasetë gjoja të vërtetë, por që tashmë, edhe vetë ata që e kanë bërë, edhe të gjithë, e dinë se nuk ka ekzistuar, nuk ekziston, është një manipulim dhe personat do të mbajnë përgjegjësi para ligjit, siç e kemi thënë që në ditën e parë. Personat që e disponojnë atë regjistrim, sot nuk shkojnë në prokurori.

E vetmja gjë që mbahet mend nga fjala e Lulzim Bashës sot në foltoren e Kuvendit, është se ai qenka i shqetësuar për dëshmitarin X.

Lulzim, nëse ti e njeh dëshmitarin X, merre dhe çoje edhe atë në prokurori! Nga dita kur në këtë çështje ka hyrë prokuroria, asnjëri prej nesh nuk duhet të flasë më, as Lulzimi, as Saliu, as Salianji, as Alibeaj e askush tjetër.

Kjo është e turpshme dhe konfirmon gjithçka që po themi. Ky ka qenë një kurth, i cili nuk funksionoi kurrë. U synua të bëhej pis ministri i Brendshëm, të cilin e kemi falënderuar në këtë sallë për punën e shkëlqyer që ka bërë në drejtimin e Komisionit për Reformën në Drejtësi dhe sigurisht, përfitoj nga rasti ta falënderoj për punën e shkëlqyer që po bën në krye të Ministrisë së Brendshme, qoftë në vettingun në polici, qoftë në forcimin e ligjit, për ta pastruar njëherë e përgjithmonë Shqipërinë nga grupet kriminale.

Falënderoj Fatmir Xhafajn për punën e shkëlqyer që ka bërë dhe, sigurisht, pa u zgjatur, do të doja t'i kërkoja, edhe një herë, kësaj opozite, e cila është për të ardhur keq, që të heqë dorë nga historia për ta bërë pis imazhin e Shqipërisë dhe nga përpjekja e saj, deri më 28 qershor, për ta dëmtuar, sa të mundet, procesin e hapjes së negociatave!

Partia Socialiste është e bindur se rekomandimi i Komisionit Europian për hapjen e negociatave është vlerësimi më i mirë për gjithçka ne kemi bërë deri tani dhe, sigurisht, është angazhimi thelbësor për të vazhduar reformat që kemi bërë deri tani.

Nëse Partia Demokratike, edhe në frymën e marrëveshjes së 17 majit të vitit 2017, është e gatshme që, bashkë me ne, të kontribuojë në këtë proces kaq të rëndësishëm, meqenëse javën e ardhshme në këtë sallë do të kemi debatin dhe më pas rezolutën për miratimin e një qëndrimi të përbashkët në qasjen ndaj rekomandimit dhe rrugës sonë europiane, e ftoj opozitën të heqë dorë nga transmetimet në Facebook të Lulit. Por ajo që është më e turpshme është se personi që mbante kamerën, është po i njëjti person që fshiu serverët e 21 janarit. I njëjti person, që fshiu serverët e 21 janarit, sot brenda në parlament mban kamerën për të filmuar në Facebook Lulzimin. Megjithatë, këto janë çështje që i takojnë drejtësisë. Edhe "21 Janari", edhe "Gërdeci", edhe "Rruga e Kombit" janë çështje, të cilat drejtësia e re që po lind duhet dhe do t'i hetojë, sikurse edhe çështje të tjera, që lidhen me historinë 27-vjeçare të këtij

vendi, që kanë të bëjnë me vrasje, që kanë të bëjnë me djegie të organeve të medieve e të tjera me radhë, që janë çështje ende të pahetuara dhe duhet t'u shkohet deri në fund.

Thirrja ime, në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, është që seanca e radhës duhet të na bëjë bashkë, në funksion të miratimit të rezolutës. Të gjithë deputetët, qofshin ata në krahun e majtë apo të djathtë të sallës, e kanë marrë projektrezolutën dhe është detyrim i Kuvendit të Shqipërisë, sipas ligjit "Për rolin e Kuvendit të Shqipërisë në procesin e integritetit evropian", që ta miratojë atë rezolutë dhe, përtej fjalëve, ne të kalojmë në vepra.

Deri sot dhe në çdo moment në asnjë rast nuk ka një fakt që të tregojë se Partia Demokratike dhe Lulzim Basha po e ndihmojnë Shqipërinë në rrugën e hapjes së negociatave.

Deri sot fakti është se Partia Demokratike dhe Lulzim Basha, bashkë me Saliun e me këdo tjetër, po bëjnë gjithçka munden për t'i prishur punë Shqipërisë në rrugën e integritetit evropian. Edhe historia e kasetës, e regjistrimit të vëllait të ministrit dhe gjithçka tjetër, ka të bëjë vetëm me prirjen për t'i bërë dëm Shqipërisë.

Sot Shqipëria është në rrugë të sigurt për hapjen e negociatave. Jo vetëm Gjermania, por edhe vendet e tjera anëtare të Bashkimit Europian, unë jam shpresëplotë, parlamentet e tyre dhe më pas qeveritë, më 28 qershor do të konfirmojnë rrugën europiane të Ballkanit Perëndimor dhe të Shqipërisë, bashkë me Maqedoninë fqinje.

Faleminderit!

(Duartrokitje në sallë)

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Balla!

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – I nderuar zoti Kryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë,

Dy vjet më parë ky parlament ndërmori reformën më të madhe, reformën në drejtësi, pjesë e së cilës ishte edhe dhënia fund e drejtësisë së vonuar, që është një drejtësi e mohuar.

Kemi pasur si pikësynim t'i japim qytetarit shqiptar një drejtësi me procedura të thjeshta, të shpejta, të lehta, me sa më pak kosto financiare, me sa më pak shpenzim kohe dhe pa pasoja ose mundësisht viktime dhe akuzuesi (dy palë të

dëmtuara, dy palë në konflikt) të dalin nga një proces civil, tregtar, penal, administrativ me sa më pak pasoja.

Sot, pas dy vjetësh, kur Kushtetuta u miratua me 140 vota dhe ne premtuam që, si parlament, pavarësisht se jemi të majtë ose të djathtë, do t'i jepnim qytetarit drejtësinë sa më shpejt, opozita jo vetëm nuk është e pranishme, por e baltos reformën në drejtësi.

Një ndër ligjet që ne po diskutojmë sot dhe do ta miratojmë është ai "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin "Për ndërmjetësimin"". Ky ligj është shumë i rëndësishëm për çdo qytetar dhe ne kemi përgjegjësinë jo vetëm morale, por edhe ligjore, t'i ofrojmë çdo qytetari, në kontakt me sistemin e drejtësisë penale, civile, administrative, tregtare dhe familjare, rrugën më të thjeshtë dhe më të lehtë.

Dokumenti i Analizës së Sistemit të Drejtësisë tregon se ndërmjetësimi në Shqipëri, që është një nga format më bashkëkohore dhe humane të trajtimit të çështjeve, nuk ka dhënë efektet e duhura. Gjykatat nuk e kanë aplikuar gjerësisht këtë proces. Mundësia për të pasur korrupsion, kur zbaton ndërmjetësimin, është shumë e limituar, sepse pa të ka procedura të ndërlikuara të hetimit dhe të gjyqimit të çështjeve. Shumica e ndërmjetësve e marrin licencën pa kaluar asnjë trajnim, as formimin fillestar, as atë vazhdues, por thjesht me studim dosjesh. E pra, në këtë Kuvend ne kemi vendosur t'u japim fund këtyre praktikave, me të cilat përballen shtetasit tanë në sistemin e drejtësisë.

Ndryshimet që ofron ky projektligj, që është nismë e deputetëve të maxhorancës, dhe në këtë rast do të doja t'i falënderoja të gjithë ata, vijnë në përputhje me standardet e Kodit Etik Europian, me direktivën kuadër të Bashkimit Europian, si dhe me rekomandimet e Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës. Ky projektligj u ofron qytetarëve zgjidhje të shpejta, të thjeshta dhe me sa më pak kosto.

Për këtë projektligj, të nderuar kolegë, ka pasur një proces të gjatë konsultimi. Dua ta theksoj këtë proces, për t'i dhënë fund çdo hamendësimi dhe baltosjeje, që opozita u bën projektligjeve të reformës në drejtësi. Jo vetëm që nuk vjen në diskutime dhe nuk kontribuon për përmirësimin e projektligjeve ose të paktën të thotë një fjalë të mirë për to, por i baltos ato. Dua të theksoj se në diskutimet për këtë projektligj,

që kanë zgjatur një vit e gjysmë, ka pasur pjesëmarrje shumë të mirë të Dhomës së Ndërmjetësimit, shoqërisë civile, ekspertëve të Gjykatës së Lartë, përfaqësuesve të Ministrisë së Drejtësisë, *think-tank*-ut, profesorëve, akademikëve, por në mënyrë të veçantë të ekspertëve të Bashkimit Europian mbështetur nga misioni EURALIUS, të cilët i falenderoj në mënyrë të veçantë.

Dua të theksoj se sot qytetarët mund të marrin shërbime shumë më të mira ndërmjetësimi nga ndërmjetës, të cilët janë të formuar dhe cilësia e tyre do të kontrollohet shumë mirë, pa qenë nevoja të hapin procese gjyqësore. Këtë gjë duhet ta bëjë çdo deputet për të informuar qytetarët.

Të nderuar kolegë,

Në këtë projektligj u kemi kërkuar gjykatave, që funksionin e tyre të mos e bëjnë në mënyrë formale, siç e kanë bërë deri më sot, por të japin njoftime dhe udhëzime të qarta, si dhe të informojnë palët për mundësinë e zgjidhjes së konflikteve jo nëpërmjet rrugës gjyqësore. Në këtë mënyrë, të nderuar kolegë, ne kontribuojmë në sistemin e drejtësisë duke ulur volumin e punës së gjykatave, që proceset gjyqësore të mos enden në dyert dhe tavolinat e gjyqtarëve për vite të tëra, si dhe lehtësojmë dhembjen dhe koston e shumë palëve në proceset e ndryshme që mund të përballen.

Të nderuar kolegë,

Duke qenë se relatori do ta kishte të vështirë të vlerësonte veten, më lejon të falenderoj atë dhe gjithë anëtarët e Komisionit të Ligjeve, që kanë punuar si ekip, bashkë me ekspertët e misionit EURALIUS, për përmirësimin e këtij projektligji. Unë shpresoj dhe uroj që gjykatat e vetuara do të dinë t'i orientojnë shumë mirë palët në proces!

Ju ftoj ta votojmë këtë projektligj dhe i kërkoj ministres së Drejtësisë të fillojë sa më shpejt procedurat për hartimin e akteve nënligjore me qëllim fillimin e zbatimit me sukses të këtij projektligji.

Për dijeninë tuaj, në datën 14 qershor Shqipëria do të jetë vendi pritës i Konferencës Europiane për Drejtësi Restauruese. Jemi një ndër modelet e mira në Europë, me të cilin duhet të krenohemi dhe kemi çfarë të themi edhe në kuadër të hapjes së negociatave.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Fjalën e ka zoti Çuçi në emër të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Bledar Çuçi – Faleminderit, Kryetar!

Të nderuar kolegë,

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.10\385, datë 24. 02. 2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”, siç e tha edhe parafolësja, është një ndër ligjet e propozuara në kuadër të reformës në drejtësi.

Dokumenti i analizës së sistemit të drejtësisë ka evidentuar se procedura e ndërmjetësimit në Shqipëri është aplikuar në mënyrë të kufizuar dhe impakti i ndërmjetësve nuk ka pasur efektin e pritshëm.

Disa nga përfundimet e pasqyruara në analizën e sistemit të drejtësisë për ndërmjetësimin janë:

1. Zbatimi i ligjit aktual për ndërmjetësimin nuk ka arritur qëllimin e tij, pasi ky ligj nuk është harmonizuar me pjesën tjetër të legjislacionit, kryesisht kodet dhe ndryshimet që kanë pësuar kodet në funksion të reformës në drejtësi. Kjo bën që edhe praktika gjyqësore të jetë e kufizuar në lidhje me njohjen dhe zbatimin e institutit të ndërmjetësimit.

2. Gjykatat nuk janë treguar aktive në thirrjen e ndërmjetësuesve për t'u adresuar atyre zgjidhjen e disa lloje çështjesh, veçanërisht ato me karakter familjar dhe pasuror në vlerë të vogël.

3. Megjithëse ky institut mbetet relativisht i ri, veçanërisht në aspektin institucional të tij, konstatohet se nuk ka gjetur zbatimin e duhur në fushën e së drejtës.

Së fundi, nga pikëpamja statistikore, nga të dhënat e Regjistrit të Ndërmjetësve rezultojnë se nga 567 subjekte të licencuara, ushtrojnë në praktikë funksionin e ndërmjetësit 73 subjekte.

Ndryshimet e reja që propozohen në ligjin “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve” fokusohen kryesisht në modernizimin e statusit të ndërmjetësit duke forcuar dhe konsoliduar njëkohësisht standardet etike sipas Kodit Etik Europian.

Po them edhe dy fjalë për procesin e hartimit.

Përgatitja e këtij projektligji, që është bërë në kuadër të reformës në drejtësi, ka nisur në muajin janar të vitit 2016 me mbledhjet e përbashkëta të grupit të ekspertëve të nivelit të

lartë, që asistuan Komisionin e Posaçëm të Reformës në Drejtësi, sekretariatit teknik, si dhe misionit të Bashkimit Europian për drejtësinë.

Me përfundimin e strukturës dhe draftit të parë të projektligjit, projektligji iu nënshtua një diskutimi nga një grup *think-tank*-u i shërbimeve ligjore dhe profesioneve të lira, në përbërje të të cilit kishte ekspertë nga Ministria e Drejtësisë, përfaqësues të Gjykatës së Lartë, Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve, si dhe nga fondacioni “Zgjidhja e Konfliktëve dhe Pajtimi i Mosmarrëveshje”.

Në të gjitha fazat e hartimit të projektligjit janë marrë opinionet dhe propozimet e grupeve të interesit, një pjesë e të cilave janë pasqyruar në draftin e depozituar në Kuvend dhe në datën 30 janar të vitit 2017 u zhvillua një tryezë e gjerë konsultimi publik me të gjithë aktorët e përfshirë në fushën e ndërmjetësimit.

Të nderuar kolegë,

Në projektligjin që paraqitet sot për miratim propozohen në mënyrë të përmbledhur këto shtesa dhe ndryshime:

përshtatja e terminologjisë me ndryshimet e Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurës Penale, me direktivën e BE-së për ndërmjetësimin, si dhe me rekomandimet e Këshillit të Europës për ndërmjetësimin në fusha të veçanta; shtimi i disa fushave të tjera, ku mund të ushtrohet ndërmjetësimi, si: pronësia intelektuale, të drejtat e konsumatorëve, si dhe mosmarrëveshjet ndërmjet organeve të administratës publike dhe subjekteve private; licenca e ndërmjetësit jepet në mënyrë nominative, individuale, për çdo individ që plotëson kushtet për t’u licencuar dhe për t’u regjistruar si ndërmjetës; parashikimi i ndërmjetësimit për çështje penale për të miturit, në përputhje me ndryshimet e bëra në Kodin e Drejtësisë për të Mitur; fuqizimi i Dhomës Kombëtare të Ndërmjetësve; kryerja e licencimit nga ministri i Drejtësisë, duke hequr komisionin e licencimit, që aktualisht është një strukturë e tepërt dhe një kosto e panevojshme; forcimi i kriterëve për të qenë ndërmjetës, duke përcaktuar ciklin e studimeve të nivelit të dytë, rritjen e moshës nga 25 në 28 vjeç si dhe vendosja e kushtit që të ketë të paktën 3 vjet eksperiencë profesionale; përcaktimi i disa profesioneve të caktuara që duhet të ketë ndërmjetësi për disa çështje të veçanta, si, për shembull, për çështjet

që përfshijnë interesat e të miturve, mundësisht duhet të jenë juristë, psikologë dhe punonjës socialë të diplomuar ose të kenë eksperiencën, trajnimin e duhur dhe specifik në këto fusha; rritja e rolit kontrollues dhe mbikëqyrës të Ministrisë së Drejtësisë për licencimin dhe procedimin disiplinor të ndërmjetësve, si dhe vendosja e kushtit që ndërmjetësi e humbet licencën nëse nuk ushtron veprimtarinë si ndërmjetës në mënyrë të njëpasnjëshme për dy vjet.

Në përfundim, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut konstatoi se në aspektin ligjor projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi, si dhe në aspektin procedural është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Prandaj, të nderuar kolegë, ju ftoj që ta votojmë këtë ligj!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zoti Çuçi!

Këtu mbyllem diskutimet për projektligjin e parë.

Vazhdojmë diskutimet për projektligjin “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Për të prezantuar projektligjin fjalën e ka ministria e Kulturës, zonja Kumbaro.

Mirela Kumbaro – Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të dashur shqiptarë, që na ndiqni nga ekrani,

Sigurisht, ky është një moment i rëndësishëm, sepse jemi në stacionin e fundit të një pune gjigante për trashëgiminë kulturore.

Para se të flas për ligjin, në fakt, dua t’ju prezantoj botimin e fundit të Ministrisë së Kulturës, që ka dalë dje nga shtypi, katalogun e objekteve të humbura për periudhën 1990-2016.

Në fakt, janë 2249 objekte, pasuri kulturore, ku e dhëna e fundit daton në vitin 2012. Këto pasuri kulturore deklarohen të humbura nga fondet dhe koleksionet publike të muzeve dhe institucioneve kombëtare apo vendore të Republikës së Shqipërisë, duke theksuar edhe një herë se datojnë nga viti 1991 deri në vitin 2012, pavarësisht se ne kemi përfshirë edhe periudhën e viteve të fundit.

Këto janë objektet, që ne kemi arritur t’i identifikojmë pas investigimeve tona në procesin 4-vjeçar të regjistrimit të pasurive kulturore në

çdo cep të Shqipërisë, në institucionet publike muzeore, qofshin ato qendrore apo vendore, të cilat figurojnë të regjistruara tashmë në Regjistrin Kombëtar të Pasurive Kulturore. Ky proces nuk është kryer që nga viti 1990, madje ju nuk do ta besoni, por as në Muzeun Historik Kombëtar, në zemër të Tiranës, procesi i regjistrimit të atij koleksioni të jashtëzakonshëm, me të cilin ne krenohemi, nuk ishte kryer asnjëherë. E si të mos lulëzonte pastaj trafikimi i objekteve të pasurisë kulturore në gjithë këta vjet të trazicionit, ku fajtorët iknin në drejtim të paditur?! Grabitjet dhe dëmtimet më të mëdha të trashëgimisë kulturore u evidentuan, natyrisht, në vitin 1997, si pasojë e vjedhjeve dhe shkatërrimit të gjithçkaje në Shqipëri, jo vetëm të pasurive kulture. Duke shfrytëzuar situatën e rëndë të sigurisë së krijuar gjatë atij viti të tmerrshëm, u shkatërrua dhe u grabit një pjesë e rrjetit muzeor kombëtar. Gjithashtu, u dëmtuan shumë monumente të kulturës së luajtshme dhe të paluajtshme. A është bërë ndonjëherë ndonjë inventar për të parë se si dolëm nga ai kiamet? Asnjëherë! Përveç krijimit të thashethemeve se si këto objekte vidheshin nga udhëtarë të huaj, duke i akuzuar ata, ne asnjëherë nuk e vendosëm gishtin mbi veten tonë për të akuzuar, në radhë të parë, qeveritë, institucionet tona përgjegjëse, më pas edhe vetë shoqërinë për indiferencën. Të paktën të pranohim padijen, terrin informativ, sepse, le t'i them gjërat siç janë, asnjëherë kultura dhe trashëgimia kulturore nuk janë marrë seriozisht nga politika.

Detyra e parë për çdo shtet është të dokumentojë pasuritë e tij, sidomos gjendjen e pasurive kulturore, me qëllim që të ndërtojë strategji dhe prioritete, por edhe rregulla të qarta në fushën e mbrojtjes dhe ruajtjes së trashëgimisë kulturore.

Pra, në vitin 2014 ne trashëguam një situatë pa situatë. Gjatë dy vjetëve, 2014-2015, ne i ramë kryq e tërthor vendit për të prekur dhe për të parë çfarë gjetëm në listën ekzistuese të monumenteve të kulturës.

A e dini, të nderuar deputetë, se mbi 100 objekte, pasuri kulturore, nuk ekzistonin fare, ndërkohë që ishin në listë, por në territor ishin zhdukur, ishin fshirë nga faqja e dheut? Madje ishin shkatërruar edhe 200 objekte të tjera, të cilat ishin në gjendje thellësisht të rrezikuara, pa

folur pastaj për 600 objekte të tjera nga kjo listë, që kërkonin ndërhyrje urgjente.

Si mund të ishte ndryshe kur jo pak prej tyre nuk i kishte vizituar askush, aq sa kishave u kishin mbirë pemët brenda në altar dhe u kishin dalë mbi çati, si: në Delvinë, në Krujë, në Dropull, ose grabiteshin në mes të ditës, siç ndodhi në ikonostasin e kishës së Shën Mërisë në Voskopojë në vitin 2009 apo në kishën e Shën Kollit në Rehovë. Më keq akoma në Elbasan, në janar të vitit 2013 u dhunuan për t'u grabitur afresket origjinale të Onufrit në kishën e Shën e Premtes në Valsh.

Sot afresku, fatmirësisht, është restauruar dhe rindërtuar brenda kishës së Valshit, pas 3 vjetëve punë në laboratorët e Institutit të Monumenteve të Kulturës.

Nuk po flasim për gjendjen e mjerë të thesareve, si: fotot e Marubit, ikonat mesjetare të Korçës, apo koleksioni arkeologjik i Durrësit, që dergjeshin bodrumeve deri në zgrip të shkatërrimit.

Përtej ndërhyrjes me emergjencë, mes operacioneve të shpëtimit, në mbi 450 objekte në 4 vjet, nga Shkodra në Sarandë; përtej studimit dhe planifikimit të mbi 10 qendrave të reja historike, disa prej të cilave janë tashmë në kantier restaurimi, si: Vunoi, Dhërmiu, Vlora; përtej alarmit për Gjirokastrën në vitin 2013, që jo vetëm e gjetëm në një lëngatë të gjatë, por edhe në linjën e rrezikut nga UNESCO, ku mbi 200 banesa ishin braktisur nga pronarët, nga bashkia dhe nga shteti, sot në Gjirokastrë sapo kemi mbyllur një pjesë të kantierit para se të vijojmë me pjesën tjetër të qytetit, falë partneriteteve me Fondacionin Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim dhe Bankën Botërore dhe ende ka shumë punë për të bërë, për t'i rikthyer Gjirokastrën shkëlqimin e historisë; përtej shkatërrimit të vullnetshëm të monumenteve në mes të ditës nga individë që iknin vetëm në drejtim të paditur, siç ndodhi me Shtëpinë e Flamurit më 2013, në Korçë, të cilën e rindërtuam vitin e kaluar; përtej ndërtimeve të paligjshme, njëherazi skandalozisht të ligjëruara, që nga kalaja e Lezhës e deri në zemër të Tiranës, te sheshi "Nënë Tereza", ku ngrehina më të shëmtuara s'bëheshin, u legalizuan dhe u hipotekuan të gjitha bashkë në gusht të vitit 2013.

A e dini se në të gjithë operacionin e restaurimit të sheshit “Nënë Tereza”, në prag të vizitës së Papa Françeskut, Ministria e Kulturës, që t’i prishte e t’i pastronte mynxyrat nga sheshi, u detyrua t’i shpronësonte, duke paguar nga paratë e taksapaguesve shqiptarë, a thua se nuk mjaftonin 2 milionë dollarë borxh, që trashëguam në buxhetin e Ministrisë së Kulturës, që edhe ashtu ishte e është mjaft i brishtë?!

E pra, të gjitha këto përvoja të mandatit të parë na treguan se Trashëgimia Kulturore, nuk mund të jetë një paketë spaletash, që i vëmë mbi supe për t’u krenuar bosh e për t’u kapardisur, e as një argument për të shtyrë kohën në Facebook me deklarata hipokrite e cinizëm dembel, sa herë restaurohet një objekt dhe rehabilitohet një muze apo një park arkeologjik.

Trashëgimia, të nderuar kolegë, është një pasuri kombëtare, edhe botërore gjithashtu, kur bëhet fjalë për site të rëndësishme të veçantë, por kjo do të thotë se është pasuri kolektive, dhe si e tillë, të gjithë aktorët e shoqërisë kanë përgjegjësi ta mbajnë e ta mbrojnë. Nuk është e mundur që çdo individ vetëm të krenohet, ndërsa përgjegjës të jetë vetëm rrogëtari i radhës në sektor. Nuk mund të shihet vetëm si interes biznesi nga sektori privat, ndërsa mirëmbajtja të bëhet vetëm me fonde publike. Nuk mund të pretendojmë të zhvillojmë turizmin e të mos konsiderojmë si prioritet strategjik, edhe ekonomik bashkë, trashëgiminë kulturore. Trashëgimia kulturore dhe fondi muzeal janë fusha ku të gjithë aktorët e shoqërisë kanë një rol për të luajtur. Për këtë duhen rregulla të qarta, ligje të detajuara dhe procedura të shpjeguara mirë. Kjo është arsyeja se pse katër vjet më parë nisëm punën për një kuadër të ri ligjor.

Projektligji “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”, që sjellim sot, përfaqëson konkluzionin e një procesi legjislativ, të filluar nga Ministria e Kulturës në prill 2014, proces i cili, nëpërmjet ekspertëve të ndryshëm të trashëgimisë kulturore, të së drejtës, por edhe të peizazhit dhe urbanistikës, kanë vlerësuar sfidat e së ardhmes nën një kontekst historik të viteve të shkuara nën legjislacionin në fuqi të trashëgimisë kulturore.

Qëllimi i këtij projektligji është ruajtja, mbrojtja, vlerësimi dhe administrimi. Janë katër shtyllat e këtij projektligji të trashëgimisë kulturore kombëtare, përfshirë trashëgiminë

kulturore materiale dhe jomateriale, si kontribut në ruajtjen e kujtesës kombëtare në territorin e Republikës së Shqipërisë, dhe si nxitje e zhvillimit kulturor të vendit, duke vlerësuar si pasuritë kulturore të mbitokës, ashtu edhe ato të nëntokës dhe të nënujit.

Gjithashtu, qëllimi i projektligjit është të përcaktojë marrëdhëniet dhe rregullat për krijimin, akreditimin, funksionimin dhe menyrën e organizimit të muzeve publikë dhe privatë në Republikën e Shqipërisë.

Gjithashtu, vënia në mbrojtje e pasurisë së peizazhit kulturor, është po ashtu një nga qëllimet parësore të projektligjit.

Ministria e Kulturës, në të gjitha vendimmarrjet e veta që nga viti 2015 e ka zbatuar Konventën Ndërkombëtare të Mbrojtjes së Peizazhit, duke e bërë atë pjesë të kuadrit të brendshëm ligjor, por sot në këtë projektligj i kushton një kapitull më vete.

Vetë projektligji në tërësi ka gjashtë pjesë të rëndësishme. Prej më të rëndësishmeve do të dalloja pjesën e dytë: Identifikimi, mbrojtja dhe vlerësimi i pasurive kulturore, që, në fakt, është edhe pjesa më e rëndësishme dhe reformuese e këtij ligji. Një kapitull i veçantë u dedikohet muzeve, që zgjeron dukshëm konceptin e funksionit të tyre.

Ndërkohë, dua të theksoj se, me gjithë nxitjen që u kemi bërë në mandatin e kaluar investimeve publike në qendrat historike dhe programet e Rilindjes Urbane, që kanë ndërhyrë jo pak edhe në restaurime të pronave private, të mos harrojmë se vetëm në Dhërmi e Vuno mbi 400 objekte, në të cilat po ndërhyhet, janë pronësi private, ndërsa në Gjirokastrë, në restaurimin e Qafës së Pazarit, të gjitha objektet janë gjithashtu pronësi private, e megjithatë, në një kuptim afatgjatë, pronarët e banesave private – pasuri kulturore, nuk investojnë në mirëmbajtjen e tyre, pikërisht sepse nuk ka mekanizma ligjorë e financiarë që t’i nxisin, me këtë ligj ne e rregullojmë me mekanizma të qartë e me procedura shumë transparente menyrën se si realizohet ky bashkëpunim.

Nga ana tjetër, puna prej katër vjetësh në sektorin e promovimit, mbrojtjes dhe administrimit, brenda kornizës së ligjit ekzistues, në shqyrtimin e shumë projekteve në të dy këshillat kombëtarë, në kontekstin e planifikimit të territorit të munguar deri para katër vjetëve

dhe të nevojave për ndryshim, në përpjekjet për të gjetur rrugë të reja për të shpëtuar dhe mbrojtur pasuritë kulturore të braktisura nga pronarët, në kushtet kur objektet pasuri kulturore të vjedhura apo të humbura nuk kanë një kornizë ligjore të plotë për t'u trajtuar në këto vite të gjata tranzicioni; në përpjekjet për të shtuar burimet e kufizuara financiare, sepse financat publike asnjëherë nuk do të jenë të mjaftueshme; në prani të disa kundërshtive që mbart vetë ligji aktual, në mungesën e plotë ose të pjesshme të disa aspekteve të rëndësishëm të trashëgimisë kulturore, siç është arkeologjia nënujore, siç është trashëgimia kulturore jomateriale, e kështu me radhë; në mungesë të masave nxitëse për financime plus, në kontekstin kur trashëgimia kulturore ka lënguar ndoshta më shumë se çdo sektor tjetër, ne, për të gjitha këto, e jo vetëm, hartuam këtë projektligj të ri, i cili i përgjigjet një realiteti të ri, një vizioni të ri dhe një strategjie të re për të siguruar jetëgjatësinë e saj.

Dua të theksoj vetëm tri elemente, të cilat i konsideroj si risi absolute në këtë projektligj.

Fillimisht, për të parën herë krijohet një fond i ri kombëtar i kujdesit për trashëgiminë kulturore, për ruajtjen e vlerave, që vjen si pjesë e praktikave më të mira për nxitje ndaj veprimtarisë kulturore të trashëgimisë.

Gjithashtu, parashikohen forma të reja të administrimit të pasurive kulturore, për të cilat, procedurat për aplikimin e tyre, rast pas rasti janë të qarta dhe me vendimmarrje kolegjiale.

Projektligji propozon një formë shumë të rëndësishme të menaxhimit të trashëgimisë kulturore. Konkretisht, besoj se kjo do të tërheqë vëmendjen tuaj, e kam fjalën për fondacionet kulturore, për një risi absolute në këtë ligj, por edhe në kuadrin ligjor shqiptar.

Fondacioni në vetvete nuk është shpikje e këtij ligji, por ne e përfshijmë si formë të re menaxhimi në pasuritë kulturore me qëllime jofitimprurëse, si formë bashkëpunimi me partnerë të ndryshëm: bashki, donatorë, biznese e të tjera.

Të nderuar deputetë,

Do të kërkoj vëmendjen tuaj për të thënë dy gjëra shumë të rëndësishme. Dua të theksoj disa elemente, që kanë të bëjnë me faktin se këtu kemi një punë katërvjeçare, të ndërmarrë me shumë sfidë nga Ministria e Kulturës, por të mbështetur fuqishëm nga shumë bashkëpunëtorë

e partnerë ndërkombëtarë, që nga ekspertët e UNESCO-s dhe të Komisionit European, ku një ndër lavdërimet në progresraportin e fundit për Shqipërinë ishte pikërisht hartimi i këtij projektligji, si një prej arritjeve të suksesshme të qeverisë shqiptare; gjithashtu u mbështet fuqishëm nga partnerët tanë strategjikë, siç është Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, që në ka mbështetur fort me ekspertizë të nivelit të lartë, pikërisht sepse besojnë te ne dhe sepse e vlerësojnë shumë potencialin e madh kulturor!

Faleminderit, Michael, dhe mirë se erdhe në Shqipëri!

U jam pa fund mirënjohëse të gjithë partnerëve! Dua të falënderoj kolegët deputetë të Komisionit të Kulturës, të Komisionit të Ligjeve, veçanërisht Milvën, Klotildën, Ulsiun, Fidelin, Bashkimin dhe kolegët tanë të këtyre dy komisioneve. Dua të falënderoj kolegët e Komisionit të Integritetit, që na mbështetën fort, por edhe ndihmuan me sugjerimet e tyre. Dua të falënderoj, gjithashtu, edhe disa kolegë të opozitës, të cilët në këta pesë muaj arritën të ngriheshin mbi politikën e lodhur dhe t'i jepnin sadopak vëmendje këtij ligji, i cili nuk është aspak i Partisë Socialiste, por është ligj i Shqipërisë europiane që duam.

Nga ana tjetër, shpreh keqardhje të thellë për baltosjen, përdhosjen, braktisjen dhe keqpërdorimin që opozita i bëri çdo ore pune, për të parashikuar e për të përmirësuar këtë ligj. Edhe sot, faqe shqiptarëve, u tërhoqën nga votimi i një ligji, që gjoja e konsideronin të rëndësishëm, por, në fund të fundit, të gjithë bashkë ia dolëm, dhe kjo ka rëndësi.

Në fund, më lejoni t'ju bëj dy ftesa: së pari, ju ftoj ta votoni me bindje këtë projektligj, të cilin, ndoshta me pak mungesë modestie, do ta quaja në emër të të gjithëve një ligj historik!

Së dyti, të nderuar deputetë, kjo mund t'ju interesojë personalisht: nesër është Dita Ndërkombëtare e Muzeve! Merrni fëmijët, të dashurit, miqtë, madje edhe armiqët, dhe ejani në muze. Do t'ju bëjë mirë, do të bëheni më të mirë! Për më tepër, vizitat nesër janë falas për të gjithë!

Faleminderit!

Gramoz Ruçi – Faleminderit, zonja Ministre!

Zoti Balla, fjala për ju!

Taulant Balla – Zoti Kryetar,

Në radhë të parë, duke e falënderuar ministren, por më shumë se sa ministren, edhe komisionin përgjegjës, i cili ka bërë një punë të shkëlqyer, në bashkëpunim me ministrinë, për të ardhur në një variant përfundimtar të ligjit për trashëgiminë, i cili garanton ruajtjen e trashëgimisë kulturore të vendit, duke falënderuar të gjitha institucionet ndërkombëtare, që kanë bashkëpunuar me ministrinë në lidhje me draftimin e këtij projektligji, bazuar në Rregulloren e Kuvendit, do të kërkoja ndërprerjen e diskutimeve dhe kalimin në votim.

Gramoz Ruçi – Faleminderit!

Atëherë të bëhemi gati për votim.

Ju lutem, të hiqen të gjitha kartat elektronike të kolegëve deputetë, që s'janë në sallë!

Atëherë, hapet votimi për prezencën.

Mbyllet votimi.

74 deputetë janë prezentë.

Fillojmë me votimin e projektrezolutës për raportin vjetor të veprimtarisë së Bankës së Shqipërisë për vitin 2017.

Ka një votim, me elektronikë, votimi është i hapur.

Hapet votimi me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet projektrezoluta për Bankën e Shqipërisë.

Vazhdojmë me votimin e projektrezolutës për raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017.

Edhe ky votim është me elektronikë dhe i hapur.

Hapet votimi!

Mbyllet votimi.

74 vota pro. Asnjë kundër. Asnjë abstenim.

Miratohet edhe projektrezoluta për raportin vjetor të veprimtarisë së Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017.

Vazhdojmë me votimin e projektligjit “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 pro, asnjë kundër, asnjë abstenim.

Miratohet.

Vazhdojmë me votimin e neneve me kartonë.

Neni 1. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 2. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 3. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 4. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 5. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 6. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Para se të kalojmë te neni 7 kemi të depozituar një amendim nga zonja Ferhati lidhur me pikën 1 të këtij neni.

Zonja Ferhati, dëshironi fjalën?

Urdhëroni!

Klotilda Ferhati – I nderuar zoti Kryetar,

Në lidhje me amendimin e depozituar, bëhet fjalë vetëm për një saktësim, i cili harmonizon terminologjinë e të gjithë tekstit të ligjit me ndryshimet që u miratuan në Komisionin e Ligjeve. Bëhet fjalë për një përkufizim në nenin 7 të projektligjit, që ndryshon nenin 4 me titull: “Licencimi”. Në variantin e riformuluar nga Komisioni i Ligjeve, pika 1 të ndryshohet me këtë përmbajtje: “Ndërmjetësi e ndryshon veprimtarinë si person fizik ose si person juridik pas licencimit dhe regjistrimit të tij në regjistrin e ndërmjetësve sipas këtij ligji”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ta përsërisë dhe një herë?

“Ndërmjetësi e ushton veprimtarinë si person fizik ose si person juridik pas licencimit dhe regjistrimit të tij në regjistrin e ndërmjetësve sipas këtij ligji”. Ky është amendimi.

Faleminderit!

Gramoz Ruçi- Faleminderit, zonja Ferhati!

A ka mbështetje propozimi i bërë?

E hedhim në votim me kartonë saktësimin e amendimit nga zonja Ferhati. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në nenin 7. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 8. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 9. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 10. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 11. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 12. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 13. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 14. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 15. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 16. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 17. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 18. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 19. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 20. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 21. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 22. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 23. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 24. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 25. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 26. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 27. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 28. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 29. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 30. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 31. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 32. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Neni 33. Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

74 pro, 1 abstenim.

Miratohet projektligji “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”.

Vazhdojmë me projektligjin tjetër “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”.

Hapet votimi në parim me elektronikë.

Mbyllet votimi.

74 pro, asnjë abstenim.

Miratohet.

Do të kërkoja mirëkuptimin e të gjithë kolegëve, pasi projektligji është shumë i gjatë, e kam fjalën për nenet e tij, në mos gaboj, ka 279 nene, do të më falni se nuk do të artikuloj në çdo nen togfjalëshin: “Pro, kundër, abstenim”, por do të artikuloj vetëm nenin dhe fjalët “miratohet apo nuk miratohet” për efekt regjistrimi dhe për efekt kohe, se janë 279 nene.

Neni 1.

Ju lutem, kartonët!

Miratohet.

Neni 2.

Miratohet.

Neni 3.

Miratohet.

Neni 4.

Miratohet.

Neni 5.

Miratohet.

Neni 6.

Miratohet.

Neni 7.

Miratohet.

Neni 8.

Miratohet.

Neni 9.

Miratohet.

Neni 10.

Miratohet.

(Nga neni 11 deri te neni 278 miratohen me të njëjtën procedurë votimi.)

Neni 279.

Pro? Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi.

Hapet votimi.

Mbyllet votimi.

Me 74 vota pro miratohet ky projektligj.

LEGJISLATURA IX - SEANCA E DITËS SË ENJTE, 17 MAJ 2018

Vazhdojmë me miratimin e programit të punës së Kuvendit për periudhën në vijim dhe miratimin e kalendarit 3-javor të punimeve të Kuvendit për periudhën në vijim.

Ju njoftoj se ditën e hënë, në datën 14 maj 2018, u mbledh Konferenca e Kryetarëve, e cila diskutoi për draftprogramin dhe draftkalendarin 3-javor për periudhën në vijim. Opozita, siç e njoftova edhe në fillim të seancës, i bojkotoi punimet e Konferencës.

Për pasojë, në mbështetje të nenin 26, pika 6, dhe nenit 27, pika 4, të Rregullores duhet t'i hedhim në votim.

Kush është dakord me programin dhe me kalendarin e Kuvendit për periudhën në vijim. Kundër? Abstenim?

Miratohet.

Faleminderit!

Seanca mbyllet këtu.

(Seanca u mbyll në orën 13:30)

Kryetari i Kuvendit

Gramoz Ruçi

**Drejtori i Shërbimit të Botimeve
Parlamentare
Krenar Hajdëri**